

“Secili le të bëjë atë që mundet”!



Krishti u Ngjall!

“Secili le të bëjë atë që mundet”!

Periudha e pandemisë të krijuar nga Covid-19 ka bërë që shumë familje të kalojnë në vështirësi, jo thjeshtë ekonomike, por në kushte të mbijetesës. Kështu që të gjithë duhet të ndërgjegjësohemi që të shtojmë kontributin tonë për këto familje në nevojë, pavarësisht se të gjithë jemi të dëmtuar nga kjo situatë e vështirë ekonomike.

Mitropolia e Shenjtë e Apollonisë dhe Fierit për festën e Pashkës dhe për muajin Maj ndau më tepër se 150 pako ushqimore për familjet e varfra në të gjithë zonat e Mitropolisë sonë duke filluar nga qyteti i Fierit dhe në zonat e tjera si Libofshë, Metaj, Daullas, Kolkondas, Verri, Sheqishte, Marinës, Topojë, Seman, Sheq-Marinas, shën Pjetër, Frakull, Shtyllas.

Perëndia bekoftë gjithë dhuruesit dhe ndihmëtarët. Amin!